



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Tiranë, më 6.6.2024

Lënda: Përgjigje kërkesës për informacion nr 22

Drejtuar: Z.Harulla Rebi

Tiranë

Ne vijim te kërkesës suaj bashkëlidhur ju bëjmë me dije se:

Fusha e Fluturimit Gjirokastër (aerodromi fushor) është regjistruar me anë të certifikatës së regjistrimit leshuar nga AAC, me Nr. AF-01/2022 më datë 15.07.2022 në përputhje me nenin 59 të Ligjit Nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe me Urdhrin e Ministrit të Transporteve Nr. 130, datë 09.11.2012 “Mbi rregullat për certifikimin, regjistrimin e aerodromeve dhe obligimet e operatorëve të aerodromit”. Certifikata e regjistrimit të fushes së fluturimit (aerodromit fushor) i është lëshuar Bashkisë Gjirokastër për të operuar këto fushe me vendndodhje Gjirokastër, Shqipëri (400 05’ 21” N; 200 09’ 02” E) me pronësi shtetërore nga Bashkia Gjirokastër.

Lloji i fluturimeve që lejohen, është për avionë me peshë maksimale të ngritjes (MTOW) që nuk i kalojnë 5700 kg, për fluturime kombëtare vetëm VFR duke respektuar kushtet e mira meteorologjike (VMC), nga lindja deri në perëndim të diellit, për qëllime private dhe sportive.

Nuk ka kërkesa nderkombetare për regjistrimin e fushave të fluturimit, çdo shtet vendos rregullat e tij, bazuar në praktikat me të mira të vendeve me të zhvilluara.

Vetëm për certifikimin e aerodromeve/aerporteve ka kërkesa nderkombetare që janë ato të ICAO-s të percaktuara në Aneksin 14 vol 1, të cilat shteti ynë i ka transpozuar dhe i aplikon në përputhje me detyrimet nderkombetare.

Koordinator për të Drejtën e Informimit & Nëpunës i Mbrojtjes së të Dhënave

DANIELA ZENELI